

AKT THEMELIM

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ GECO “ sh.p.k.

FORMIMI

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “GECO ” sh.p.k., themelohet ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”. Kjo shoqeri krijohet nga ortakut i vetem Z .FOTO ZBOGO , i biri Janit dhe Uranise, i datelindjes 1949, lindur ne Dhermi dhe banues ne Tirane , Rruga " Qemal Stafa " Nr. 260/1, me Leter njoftimi UG 389245 , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar . Ortaku i lartpermendur vendosi krijimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar te emertuar “ GECO ” sh.p.k..

NENI 2

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar " GECO " SHPK eshte ne Tirane, Rruga " Qemal Stafa " Nr. 260/1 .

Ajo gezon te drejten per te hapur filiale , dege , apo agjensi te tjera si brenda ashtu edhe jashte vendit .

NENI 3

Shoqeria “ GECO ” sh.p.k. krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje kohe zgjatje mbi 10 vjet. Kjo shoqeri mund te zgjase afatin e veprimtarise se saj ose mund te mbylle aktivitetin e saj edhe para mbarimit te ketij afati, e realizuar kjo sipas dipsozitive qe percaktohen ne kete statut, me vendim te Ortakut te Vetem dhe sipas kritereve qe percaktohen ne legjislacionin ne fuqi.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 4

PUNIME MONTIMI

Montimi i linjave dhe impianteve teknologjike .



Impiante termike , ventilimit , kondicionimit si dhe mirembajtja dhe riparimi i tyre .
Impiante higjenosanitare , hidrosanitare , te gazit mirembajtja dhe riparimi i tyre .
Impiante ashensoresh, shkalle levizese , transportiere , etj . si dhe mirembajtja dhe riparimi i tyre .
Instalimi i impianteve dhe makinerive ngritese e transportuese si vinça telçferike etj .
te ketij karakteri .

Punime Hidraulike

Ujesjellesa , kanalizime , impiante vaditese etj .

Gazsjellesa , vajsjellesa etj . te ketij karakteri.

Impiante te pastrimit te ujit .

PUNIME ELEKTRIKE

Impiante per prodhimin e energjise elektrike nga burime alternative , instalime per nenstacionet , kabinat e transformatoreve , linjate e tensionit te larte dhe te mesem .
Instalimi i linjave te kabinave elektrike te tensionit te ulet , linjave per telefoni , radiotelefoni , televizive , citofonike dhe mirembajtja e tyre .

VEPRIMTARI IMPORT EKSPORT

Import eksporti e tregtimi i paisjeve, makinerive, pjeseve te kembimit, materialeve te ndertimit e te llojeve te ndryshme etj .

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, Seline , kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem .

NENI 6

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie perbehet ne te holla ne nje vlere prej 100.000 leke i ivenstuar ne mase te plote prej Ortakut te Vetem.

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme nga ortakut i shoqerise perkundrejt personave te trete. Te gjitha veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar ne natyre behen me miratimin e ortakut te vetem . Kapitali themeltar mund te shtohet ose te ndryshohet vetem me vendim te ortakut te vetem .



DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI

7

Shoqeria " GECO " SHPK eshte prone e ortakut te vetem e cila drejtohet dhe administrohet nga Administratori Z. FOTO ZBOGO .

Dispozita me te detajuara ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e Shoqerise jane percaktuar ne statut .

ORTAKU I VETEM

FOTO ZBOGO

Foto Zbogo


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 258REP.

VERTETIM

Sot, me date 17 .05.2003 (dymije e tre) para meje Noteres **Shkendie Shahu** , me zyre rr."Duresit" nr.38 Tirane u paraqit personalisht z. Foto Zbogo , i biri i Janit dhe Uranise , i datelindjes 1949 , lindur ne Dhermi dhe banues ne Tirane, Rruga " Qemal Stafa " Nr. 260/1, me Leter njoftimi UG 389245, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili deklaroi se sa siper eshte Akt Thjemelimi i shoqerise " GECO " sh.p.k. perpiluar jashte kesaj zyre sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe e nenshkroi ne pranine time dhe une Noterja e vertetoi sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
CELINDOZ/1444971

Shkendie Shahu